



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 789/2 Prot

Tiranë, më 26.10.2021

**V E N D I M**

Nr.128, datë 26.10.2021

**Mbi vlerësimin e ligjshmërisë së pretendimit të ngritur nëpërmjet kërkesës së regjistruar me nr. 789, datë 10.9.2021, për mospërputhje të përshkrimit të punës, në shpalljen për konkurrim me kod #1524 – pozicioni “*Specialist në Sektorin e Përpunimit, Menaxhimit të Arkivës dhe Marrëdhënieve me Publikun*”, me pozicionin aktual të punës në Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr.44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, si dhe Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, mbi trajtimin e informacionit, për pasaktësi në formularin e përshkrimit të punës, për shpalljen #1524 – pozicioni “*Specialist në Sektorin e Përpunimit, Menaxhimit të Arkivës dhe Marrëdhënieve me Publikun*”, në Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor,

**VËREJ SE:**

Nëpërmjet informacionit të regjistruar me nr. 789, datë 10.9.2021, është ngritur pretendimi se, përshkrimi i punës për shpalljen e DAP me kod #1524 – për pozicionin “*Specialist në Sektorin e Përpunimit, Menaxhimit të Arkivës dhe Marrëdhënieve me Publikun*”, nuk përputhet me formularin e përshkrimit të pozicionit konkret, në Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor.

Nga këqyrja e dokumentacionit të mbledhur gjatë zhvillimit të hetimit administrativ, konstatohet që, pas zhvillimit të procedurës së konkurrimit për praninë në shërbimin civil me shpalljen e DAP me kod #1524 – pozicioni “*Specialist në Sektorin e Përpunimit, Menaxhimit të Arkivës dhe Marrëdhënieve me Publikun*” në Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor, është

shpallur fituese konkurrentja \*\*\*\*\* , proces ky i përmbyllur me aktin e emërimit nr.5220 prot., datë 23.08.2017, të Departamentit të Administratës Publike.

Mosmarrëveshja e pretenduar, konsiston në faktin se, përshkrimi i punës në shpallje, për pozicionin “*Specialist në Sektorin e Përpunimit, Menaxhimit të Arkivës dhe Marrëdhënieve me Publikun*”, nuk përputhet me kërkesat dhe detyrat që përcaktohen në lidhjen 4 (Formularin e Përshkrimit të Punës), që i bashkëlidhet Vendimit nr. 888, datë 31.12.2019, të Këshillit të Ministrave “*Për organizimin dhe funksionimin e Arkivit Shtetëror të sistemit Gjyqësor*” dhe me natyrën e punës në realitet.

Konstatohet se në shpalljen me kod #1524, duke qenë se kemi të bëjmë me një konkurrim për grup pozicionesh, jepet një përshkrim përgjithësues i punës për pozicionin/et e shpallura dhe vetëm pasi konkurenti është shpallur fitues, ka të drejtë të zgjedhë një nga pozicionet e mbetura, sipas renditjes. Është pikërisht ky moment, ku kristalizohen detyrat dhe funksionet e secilit prej pozicioneve, sipas përshkrimit të posaçëm të punës.

Duke vazhduar më tej analizën e rastit, konstatohet që, sipas vendimit nr. 888, datë 31.12.2019 “*Për organizimin dhe funksionimin e Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor*”, institucioni varet nga Ministria e Drejtësisë dhe është organizuar me strukturë të sheshtë, e cila ka në përbërje: 1 Drejtor, 7 specialistë arkivi dhe 3 punonjës administrativë.

Duke qenë se veprimtaria kryesore e këtij institucioni është mbledhja, regjistrimi, menaxhimi i materialeve arkivore nëpërmjet teknologjisë së informacionit dhe sistemeve elektronike, formulari i përshkrimit të punës për pozicionin “*Specialist në Sektorin e Përpunimit, Menaxhimit të Arkivës dhe Marrëdhënieve me Publikun*”, në Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor, është i njëjtë për të gjithë punonjësit e ASHSGJ-së dhe paraqitet si një përmbledhje e kriterëve të specialistit të arkivës dhe atij të teknologjisë së informacionit, sipas kërkesave të përcaktuara në pikën 2/1 (Përshkrimi i përgjithshëm i punës për çdo kategori) dhe pikën 24 dhe 26, të lidhjes 3, të Vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, si dhe në pikën 4.2.10, të Udhëzimit nr. 1, datë 31.5.2017, të DAP “*Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil*”, e materializuar kjo në Lidhjen 4 (Përshkrimi i punës), që i bashkëlidhet vendimit nr. 888, datë 31.12.2019 “*Për organizimin dhe funksionimin e ASHSGJ*”.

Nisur nga sa u parashtrua më sipër, arrihet në përfundimin se shkak i mosmarrëveshjes në këtë rast, është perceptimi jo i drejtë, në lidhje me ndryshimin ndërmjet përshkrimit përgjithësues të punës për pozicionin/et e punës të shpallura për konkurrimin në grup pozicionesh dhe përshkrimin konkret të punës, me të cilin njihet nëpunësi në momentin që shpallet fitues dhe fillon marrëdhënia në shërbimin civil.

Një shpjegim me përmbajtje të ngjashme ka bërë dhe Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit në Fushën e Menaxhimit të Shërbimit Civil, pranë Departamentit të Administratës Publike, në e-mailin e datës 08 maj 2019.

Për më tepër, shpjegimi i njësisë përgjegjëse me të drejtë përmbillet me sugjerimin që, nëse një nëpunës civil i konfirmuar, nuk është i kënaqur me pozicionin e punës që mban, mund të aplikojë lirisht në procedurat e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë të shpallura, në të cilat ai plotëson kriteret e posaçme të kërkuara për këto pozicione.

Nga gjithë sa u parashtrua më sipër, arrihet në konkluzionin se mosmarrëveshja nuk është rrjedhojë e ndonjë keqinterpretimi apo gabimi në menaxhimin e shërbimit civil, e për këtë arsye vlerësohet që hetimi administrativ i këtij rasti të përfundojë.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 90 pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 34, pika 1, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së pretendimit se ka mospërputhje të përshkrimit të punës, në shpalljen e konkurrimit me kod #1524 – pozicioni “*Specialist në Sektorin e Përpunimit, Menaxhimit të Arkivës dhe Marrëdhënieve me Publikun*”, në Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor, me përshkrimin e punës së pozicionit konkret dhe meqenëse nuk gjenden elementë kundraligjshmërie në administrimin e këtij rasti, arkivimin e çështjes.
2. Të njoftohet për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike dhe Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**